Transferë bankare për kthimin e shumës së grantit të rindërtimit kaluar datë 17.09.2020.
Kontratë Dhurimi me nr. 947 Rep., nr. 329 Kol., datë 10.09.2018.
Vendim Gjykate me nr. Regj. Them: (21001-01530)1787, Nr. i vendimit: (11-2020-3523) 852, data e vendimit: 04.08.2020, me paditës z. Orest Fila dhe të paditur znj. Eriona Fila.

Nga komunikimi me Zyrën e Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike për trajtimin e rastit jemi informuar se se znj. Eriona Fila nuk ka dalë përfituese pasi sipas përgjigjes së ASHK-së figuron me pasuri tjetër. Në shqyrtimin e ankesës Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5 konstaton se me datë 10.09.2018 znj. Eriona Fila i është dhuruar banesa me nr. pasurie 1/1589+1-36, ZK. 8513, Vol. 73, Fq. 49 nga prindërit e saj Kujtim dhe Sanije

Llulla ndërsa pasuria tjetër për të cilën është skualifikuar subjekti rezulton të jetë banesa e ish-vjehrrit z. Ilo Fila.

Sa më sipër Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4 – DS5 referuar dokumentacionit që disponon gjatë shqyrtimit administrativ, Aktit Normativ nr. 9 si dhe legjislacionit në fuqi propozon që praktika e znj. Eriona Fila t'i kalohet Këshillit Bashkiak Durrës i cili pas trajtimit të rastit të shqyrtojë propozimin e Komisionit për përfshirjen në listën e përfituesve për njësinë e banimit me strukturë 1+1.

Sa më sipër sqarojmë se kundër këtij vendimi mund të ankimohet në Gjykatë sipas legjislacionit në fuqi.

KOMISIONI I SHQYRTIMIT TË ANKESAVE DS4-DS5

ELIO JANI

ENLI KACULI

NIKOL MUKA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
DREJTORIA LIGJORE
SEKTORI JURIDIK

PROJEKTVENDIM

Nr._____, Datë ___/____/2026

PËR
MIRATIMIN E PROCEDURËS SË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMILJET QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT PUBLIK ME OBJEKT: "LIDHJA E CURRILAVE ME RRUGËN "ALEKSANDËR GOGA"

Në mbështetje të Ligjit nr.139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; Ligjit nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar; Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; Ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", i ndryshuar, Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 384, datë 12.06.2019, "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.41, datë 21.05.2024 "Për miratimin e vlerës mesatare të qirasë së apartamenteve të banimit për efekt të subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë", Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 77, datë 06.10.2026, "Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 06, datë 10.02.2026, 'Për miratimin e vlerës së shpronësimit të pasurive private që preken nga projekti "Ndërtimi dhe zgjerimi i rrugës Currila – A. Goga"', i ndryshuar, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, kryetarja e Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe,

TË VENDOSË:

1. Miratimin e procedurës së subvencionimit të qirasë për familjet që preken nga zbatimi i projektit publik me objekt: "Lidhja e Currilave me rrugën 'Aleksandër Goga'", të cilat, si pasojë e zbatimit të këtij projekti, detyrohen të lirojnë banesat e tyre.
2. Subvencionimi i qirasë për familjet përfituese do të jepet për një periudhë jo më shumë se një (1) vit, në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për strehimin social.
3. Për llogaritjen e masës së subvencionimit të qirasë do të merret si referencë Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 41, datë 21.05.2024, "Për miratimin e vlerës mesatare të qirasë së

apartamenteve të banimit për efekt të subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë", sipas strukturës së apartamentit, si më poshtë:

- Qiraja për strukturën e apartamentit për 1+1, është 30 000 (tridhjetëmijë) lekë/muaj.
- Qiraja për strukturën e apartamentit për 2+1, është 35 000 (tridhjetepesëmijë) lekë/muaj.
- Qiraja për strukturën e apartamentit për 3+1, është 40 000 (dyzetëmijë) lekë/muaj.

4. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i Bashkisë Durrës, nëpërmjet fondeve të planifikuara në Programin Buxhetor Afatmesëm 2027–2029, në përputhje me ligjin nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar.
5. Përfitimi nga subvencionimi i qirasë do të kushtëzohet nga plotësimi i kritereve ligjore dhe paraqitja e dokumentacionit të kërkuar nga familjet përfituese, si më poshtë:
   i. Për të dhëna personale të aplikantit:
      - certifikatë familjare e aplikantit;
      - vërtetim për vendbanimin në njësinë e vetëqeverisjes vendore.
   ii. Për vërtetimin e kushteve të strehimit, sipas shkronjës "a", të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social" i ndryshuar:
      - vërtetim nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës (ish zyra Vendore e Regjistrimit të Pronave të Paluajtshme Durrës) për pronat që disponohen në emër të secilit anëtar të familjes;
      - vërtetim nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës që aplikanti apo çdo pjesëtar tjetër i familjes në moshë madhore nuk ka aplikuar për legalizim banese(origjinale).
   iii. Dokumentacion që vërteton se familja ka liruar ose është në proces të lirimit të banesës që preket nga zbatimi i projektit publik.
   iv. Kontratë qiraje për banesën e marrë me qira.

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Sociale, si dhe Drejtoria Ekonomike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore".

DREJTORIA LIGJORE
Drejtore
Alneida Rroshi

DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE
Drejtore
Diola Xhango

KRYETARE
Emiriana Sako

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE
SEKTORI I STREHIMIT SOCIAL

RELACION

PËR MIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMILJET QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT PUBLIK ME OBJEKT: "LIDHJA E CURRILAVE ME RRUGËN "ALEKSANDËR GOGA"

Të nderuar këshilltarë !

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar; Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; Ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", i ndryshuar, Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 384, datë 12.06.2019, "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.41, datë 21.05.2024 "Për miratimin e vlerës mesatare të qirasë së apartamenteve të banimit për efekt të subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë", Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 77, datë 06.10.2026, "Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 06, datë 10.02.2026, 'Për miratimin e vlerës së shpronësimit të pasurive private që preken nga projekti "Ndërtimi dhe zgjerimi i rrugës Currila – A. Goga"', i ndryshuar, Bashkia Durrës ka detyrimin dhe përgjegjësinë ligjore për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore në territorin e saj administrativ, me synim përmirësimin e shërbimeve publike dhe rritjen e cilësisë së jetesës së qytetarëve.
Në zbatim të këtyre kompetencave, neni 23 i ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, përcakton se bashkitë janë përgjegjëse, ndër të tjera, për: "4. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore."
Në ushtrim të këtij funksioni, Bashkia Durrës ka projektuar, financuar dhe lidhur kontratë me subjektet përkatëse për realizimin e investimit me objekt "Lidhja e Currilave me Rrugën 'Aleksandër Goga'". Ky projekt është pjesë e një programi zhvillimor strategjik për qytetin e Durrësit dhe synon të sjellë përmirësime të drejtpërdrejta në: a) rritjen e sigurisë rrugore; b) lehtësimin e qarkullimit të mjeteve dhe uljen e trafikut urban; c) përmirësimin e infrastrukturës së shërbimeve publike; ç) shtimin e aksesit në zonat turistike dhe ekonomike të qytetit; d) rritjen e vlerës së pasurive të paluajtshme në zonë dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për

banorët. Për realizimin e këtij investimi, Bashkia Durrës, duke respektuar të drejtën kushtetuese dhe ligjore të pronës private, si dhe detyrimin për shpërblimin e drejtë të saj, ka ndjekur procedurat për identifikimin dhe vlerësimin e pasurive të paluajtshme që preken nga projekti.

Ky relacion ka për qëllim trajtimin e nevojës për strehim të përkohshëm të familjeve që preken nga realizimi i këtij investimi publik, nëpërmjet miratimit të procedurës së subvencionimit të qirasë për familjet, pasuritë e të cilave janë të llojit banesë (ndërtesa banimi). Identifikimi i familjeve dhe verifikimi i pasurive të prekura nga investimi janë mbështetur në dokumentacionin dhe informacionin zyrtar të siguruar nga grupi i punës i cili ka marrë informacionin zyrtar pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës. Kjo procedurë synon të garantojë trajtimin e përshtatshëm të familjeve të prekura dhe të respektojë parimin e shpërblimit të drejtë, në përputhje me nenin 41 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Në përputhje me ligjin nr. 22/2018, "Për strehimin social", i ndryshuar, dhe me qëllim krijimin e mundësive për sigurimin e një strehimi të përshtatshëm e të përballueshëm, në përputhje me aftësitë paguese të familjeve në nevojë, Bashkia Durrës propozon miratimin e subvencionimit të qirasë për familjet që, si pasojë e këtij investimi publik, detyrohen të lirojnë banesat e tyre dhe mbeten pa strehim. Kjo masë synon të sigurojë strehimin e përkohshëm të këtyre familjeve deri në zgjidhjen e situatës së krijuar nga zhvendosja, duke garantuar mbështetjen e nevojshme për përballimin e shpenzimeve të qirasë.

Familjet që do të përfitojnë strehim përmes subvencionimit të qirasë, për një periudhë një vjecare, në përputhje me legjislacionin në fuqi duhet të paraqesin dokumentacionin si më poshtë:

a) Për të dhëna personale të aplikantit:

- certifikatë familjare e aplikantit;
- vërtetim për vendbanimin në njësinë e vetëqeverisjes vendore.

b) Për vërtetimin e kushteve të strehimit, sipas shkronjës "a", të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social" i ndryshuar:

- vërtetim nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës (ish zyra Vendore e Regjistrimit të Pronave të Paluajtshme Durrës) për pronat që disponohen në emër të secilit anëtar të familjes;
- vërtetim nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës që aplikanti apo çdo pjestar tjetër i familjes në moshë madhore nuk ka aplikuar për legalizim banese(origjinale).

c) Kanë liruar ose janë në proces lirimi të banesës;

d) Kontratën e qirasë.

Kohëzgjatja e subvencionimit të qirasë do të zgjasë deri në një vit. Si referencë për llogaritjen e masës së subvencionimit të qirasë është marrë VKB nr.41, datë 21.05.2024 " Për miratimin e vlerës mesatare të qirasë së apartamenteve të banimit për efekt të subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë", ku është miratuar vlera e pagesës së qirasë sipas tregut të lirë për struktura përkatëse të apartamenteve, si më poshtë:

a) Qiraja për strukturën e apartamentit për 1+1, është 30 000 (tridhjetëmijë) lekë/muaj.
b) Qiraja për strukturën e apartamentit për 2+1, është 35 000 (tridhjetepesëmijë) lekë/muaj.
c) Qiraja për strukturën e apartamentit për 3+1, është 40 000 (dyzetëmijë) lekë/muaj.

Pas paraqitjes dhe vlerësimit të dokumentacionit të kërkuar, Komisioni i Strehimit dhe Drejtoria e Shërbimit Social pranë Bashkisë Durrës do të marrin masat e nevojshme për vijimin e procedurave administrative, në bashkëpunim me njësinë administrative përkatëse, e cila do të kryejë njoftimet dhe veprimet e nevojshme për familjet përfituese. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i kësaj procedure të subvencionimit të qirasë do të përballohen nga buxheti i Bashkisë Durrës, nëpërmjet fondeve të planifikuara në Programin Buxhetor Afatmesëm 2027–2029, në përputhje me ligjin nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar.

Për sa më sipër, duke vlerësuar nevojën për garantimin e strehimit të përkohshëm të familjeve që preken nga realizimi i investimit publik "Lidhja e Currilave me Rrugën 'Aleksandër Goga'", propozojmë shqyrtimin dhe miratimin nga ana juaj të procedurës së subvencionimit të qirasë për këto familje, në përputhje me kriteret, dokumentacionin, afatet dhe masat financiare të parashikuara në këtë relacion.

Duke Ju falenderuar, mbetemi të sigurtë në bashkëpunimin tuaj.

DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL
Drejtore

Diola Xhango

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS
DREJTORIA LIGJORE
SEKTORI JURIDIK

PROJEKTVENDIM

NR._____, DATË ____/____/2026

PËR
MIRATIMIN E PËRFAQËSUESVE TË BASHKISË DURRËS NË BORDET E INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" dhe Udhëzimit nr. 25, datë 25.07.2018, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, "Për ngritjen dhe funksionimin e Bordit të institucionit arsimor", i ndryshuar, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Arsim, Kulturës, Rinisë,Sportit dhe Komuniteteve Fetare, Kryetarja e Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe,

TË VENDOSË:

1. Miratimin e përfaqësuesve të Bashkisë Durrës në bordet e institucioneve arsimore publike, të arsimit parauniversitar, sipas listës bashkëlidhur këtij projektvendimi.

2. Mandatimi i përfaqësuesit të njësisë së vetëqeverisjes vendore në bordet e institucioneve arsimore publike të arsimit parauniversitar bëhet një herë në katër vjet me të drejtë rizgjedhjeje.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen, Drejtoria e Arsim, Kulturë, Rini, Sporte dhe Komunitete Fetare.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore".

DREJTORIA ARSIM, KULTURË, RINI, SPORTE, KOMUNITETE FETARE
Drejtor

Migena Muhaj

DREJTORIA LIGJORE

Drejtor

Alneida Rroshi

KRYETARE

Emiriana Sako

Bashkia Durrës/Institucione Arsimore Parauniversitare			
Nr	**Emri i shkollës**	**Emër/mbiemër**	**Pozicioni**
	Njësia Administrative Ishëm		
1	Sh.B." Rexhep Mezini " Ishëm	Emilian Kapxhiu	Specialist shërbimesh, Njësia Administrative Ishëm
2	shkolla 9 vjeçare "Pren Simoni" Draç	Emirian Bafti	Administrator, Njësia Administrative Ishëm
3	shkolla 9 vjeçare "Xhelal Shtufi" Shkafanaj	Sali Doda	Inspektor i Emergjencave Civile, Njësia Administrative Ishëm
	Njësia Administrative Manëz		
1	shkolla 9 vjeçare "Riza Shera" Radë	Saimir Sallaku	Specialist shërbimesh, Njësia Administrative Manëz
2	shkolla 9 vjeçare Armath	Rejdi Shehu	Administrator, Njësia Administrative Manëz
3	shkolla 9 vjeçare "Zyber Sallaku" Kucok	Edmond Subashi	Roje, Njësia Administrative Manëz
4	Shkolla e mesme "Enver Farruku" Manëz	Zerina Fortuzi	Specialiste e Arkiv-Protokollit, Njësia Administrative Manëz
	Njësia Administrative Katund i Ri		
1	Sh.B." Jusuf Hoti" Katund I Ri	Juljan Marku	Administrator, Njësia Administrative Katund i Ri
2	shkolla 9 vjeçare "Artan Zeka" Qerret	Ded Mehmeti	Specialist shërbimesh, Njësia Administrative Katund i Ri
3	shkolla 9 vjeçare "Bisht Kamez"	Ilir Kuci	Inspektor veterinar, Drejtoria e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtjes Civile
4	shkolla 9 vjeçare "Bajram Gashi" Fllakë	Sonila Vrioni	Specialiste, Punonjëse Sociale, Drejtoria e Shërbimeve Sociale
5	shkolla 9 vjeçare Sukth Katund	Jetmir Kurti	Specialist, Sektori i Projekteve Publike, Drejtoria e Projekteve, Infrastrukturës Publike dhe Transportit Publik
6	shkolla 9 vjeçare " Fshat Rinia"	Riselda Selimi	Administratore shoqërore, Drejtoria e Shërbimeve Sociale
7	shkolla 9 vjeçare Jubë	Paje Shehu	Specialiste Arkiv-Protokolli, Njësia Administrative Katund i Ri
	Njësia Administrative Rrashbull		
1	shkolla 9 vjeçare "Vellezrit Haradinaj" Rrashbull	Merita Ahmeti	Administratore shoqërore, Drejtoria e Shërbimeve Sociale
2	shkolla 9 vjeçare "Myslym Hidaj" Arapaj	Fiqiri Dema	Administrator, Njësia Administrative Rrashbull
3	shkolla 9 vjeçare "Shefqet Ndroqi" Romanat	Fjorela Bashaj	Administratore shoqërore, Drejtoria e Shërbimeve Sociale
4	shkolla 9 vjeçare "Hamza Muça" Shkallnur	Anxhela Allci	Punonjëse sociale, Qendra Komunitare Multifunksionale
5	shkolla 9 vjeçare "Bilal Golemi" Xhafzotaj	Albert Bukaci	Inspektor, Sektori i Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile

6	Sh.B Besnik Hidri Shenviash	Azem Piaku	Kryepiak
	Njësia Administrative Sukth		
1	shkolla 9 vjeçare "Njazi Mastori" Sukth	Erjon Xhili	Administrator, Njësia Administrative Sukth
2	shkolla 9 vjeçare Vadardhe	Adelina Delishi	Specialist për mbrojtjen e fëmijëve (Sukth),Sektori I Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale,Drejtoria e Shërbimit Social
3	shkolla 9 vjeçare "Pal Zefi" Rrushkull	Matilda Baballeku	Përgjegjëse,Gjendja Civile,Njësia Administrative Sukth
4	C.U.Perlat	Gjergj Gerco	Specialist Ark.Prot,Njesia adm Sukth
5	shkolla 9 vjeçare Hamallaj		
6	Sh.B "Ismet Nanushi" Kullë	Majlinda Hoxha	Specialiste QEA
7	Shkolla e mesme " Dhosi Liperi" Sukth	Mirian Domi	Administrator Shoqëror Nj.adm Sukth,Sektori I Ndihmës Ekonomike dhe Paaftësise,Drejtoria e Shërbimeve Sociale
	Durrës		
1	shkolla 9 vjeçare "Bedrie Bebeziqi"	Katerina Norja	Specialiste,Sektori I Arsimit,Drejtoria e Arsim,Kulturës,Rinisë,Sporteve dhe Komuniteteve Fetare
2	shkolla 9 vjeçare "Jusuf Puka"	Elisabeta Ciko	Specialiste,Sektori I Prokurimeve Publike,Drejtoria Ligjore
3	shkolla 9 vjeçare "Shaqe Mazreku"	Daniela Murataj	Përgjegjëse,Sektori I bashkëpronësisë,Drejtoria Ligjore
4	shkolla 9 vjeçare "Nënë Tereza"	Genti Salillari	Inspektor i Kulturës dhe Komuniteteve Fetare,Drejtoria e Arsim,Kulturës,Rinisë,Sporteve dhe Komuniteteve Fetare
5	shkolla 9 vjeçare "Vasil Ziu"	Alketa Veseli	Administratore,Njësia Administrative nr 2
6	shkolla 9 vjeçare "Marie Kaçulini"	Arlin Tataveshi	Inspektor, Njësia Administrative nr 3
7	shkolla 9 vjeçare "Kushtrimi Lirisë"	Petrit Ismailati	Administrator, Njësia Administrative nr 3
8	shkolla 9 vjeçare "14 Nëntori"	Jurgen Tabaku	Specialist, Gjendja Civile, Njësia Administrative nr 5
9	shkolla 9 vjeçare "Qemal Mici"	Petrit Ismailati	Administrator,Njësia Administrative nr 3
10	shkolla 9 vjeçare "Hajdar Dushi"	Eduart Kaja	Inspektor,Njësia Administrative nr 4
11	shkolla 9 vjeçare" Eftali Koçi"	Andi Qama	Specialist Kabineti
12	shkolla 9 vjeçare "Hasan Koçi"	Arjeta Zahiri	Specialist,Sektori I Politikave të Turizmit,Drejtoria e Turizmit
13	shkolla 9 vjeçare "Neim Babameto"	Frederik Musai	Administrator,Njësia Administrative nr 4
14	shkolla 9 vjeçare "Met Hasa"	Elton Xhako	Specialist, Sektori I Marrëdhënieve me Publikun
15	shkolla 9 vjeçare "Bajram Curri"	Merita Xheneti	Inspektor urbanist,Njësia Administrative nr 5

16	shkolla 9 vjeçare" Abedin Dino"	Redion Tabaku	Administrator,Njësia Administrative nr 5
17	shkolla 9 vjeçare "Demokracia"	Olta Dedej	Përgjegjëse,Sektori I Politikave të Turizmit,Drejtoria e Turizmit
18	shkolla 9 vjeçare "Isuf Ferra"	Erion Muçka	Specialist,Njësia Administrative Rrashbull
19	shkolla speciale PLM	Pranvera Gagani	Administratore,Njësia Administrative nr 1
20	shkolla 9 vjeçare " E Re "	Davide Ndoj	Administratore,Njësia Administrative nr 6
21	ShB "Jan Kukuzeli"	Alketa Tragaj	Drejtore,Qendra Kulturore "A.Moisiu"
22	ShB "Benardina Qeraxhi"	Eulin Kociaj	Inspektor,Njësia Administrative nr 3
23	Shkolla e mesme "Dom Nikoll Kacorri"	Agustin Ndoj	Inspektor,Njësia Administrative nr 6
24	Shkolla e mesme " Gjergj Kastrioti"	Bianka Beko (Madhi)	Përgjegjëse,Sektori I Projekteve Publike,Drejtoria e Projekteve,Infrastrukturës Publike dhe Transportit Publik
25	Shkolla e mesme "Leonik Tomeo"	Ilva Hasanaj	Përgjegjëse,Sektori I Ndjekjes së Investimeve dhe Kontratave Publike,Drejtoria e Projekteve, Infrastrukturës Publike dhe Transportit Publik
26	Shkolla e mesme " Naim Frashëri "	Loranda Cani	Specialiste, Këshilli Bashkiak
27	Shkolla e mesme "Olsi Lasko"	Sara Trebicka	Specialiste, Sektori I Promovimit të Qytetit ,Drejtoria e Turizmit

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS
DREJTORIA E ARSIM, KULTURË, RINI , SPORT, KOMUNITETE FETARE
SEKTORI I ARSIMIT

RELACION

PËR MIRATIMIN E PËRFAQËSUESVE TË BASHKISË DURRËS NË BORDET E INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Të nderuar Këshilltarë,

Drejtoria e Arsim, Kulturë, Rini, Sporte dhe Komuniteteve Fetare pranë Bashkisë Durrës në bazë të kërkesave të përcjella nga institucionet arsimore publike në territorin e Bashkisë Durrës, për caktimin e një përfaqësuesi të bashkisë në bordet e institucioneve arsimore parauniversitare, në mbështetje të Udhëzimit nr. 25, datë 25.07.2018, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, "Për ngritjen dhe funksionimin e Bordit të institucionit arsimor", i ndryshuar, paraqet për shqyrtim sa më poshtë:

Në kuadër të funksionimit të bordeve të institucioneve arsimore parauniversitare, shkollat publike të Bashkisë Durrës kanë kërkuar caktimin e përfaqësuesve të Bashkisë në përbërje të bordeve të tyre.

Udhëzimi nr. 25, datë 25.07.2018, në kreun III, pika 7, përcakton shprehimisht:

"Përfaqësuesi në bord i njësisë së vetëqeverisjes vendore caktohet nga këshilli i saj."

Kjo dispozitë përcakton në mënyrë të qartë organin kompetent për caktimin e përfaqësuesit të njësisë së vetëqeverisjes vendore në Bordin e institucionit arsimor. Për rrjedhojë, caktimi i këtij përfaqësuesi duhet të realizohet nëpërmjet një vendimmarrjeje të Këshillit Bashkiak.

Gjithashtu, sipas pikës 2 të kreut II të këtij udhëzimi, titullari i njësisë arsimore vendore siguron nga njësitë e vetëqeverisjes vendore listën e përfaqësuesve të tyre në bordet e institucioneve arsimore përkatëse. Nisur nga kjo pikë, bashkia do të përcjellje zyrtarisht emrat e përfaqësuesve të caktuar me vendim të Këshillit Bashkiak.

Në këtë udhëzim, sipas kreut VI pika 1 përcaktohet shprehimisht se:

"Bordi zgiidhet një herë në tre vjet dhe përsëritja e mandatit nuk është e kushtëzuar. Mandati i përfaqësuesit të njësisë së vetëqeverisjes vendore bëhet një herë në katër vjet me të drejtë rizgjedhjeje."

Për sa më sipër, kërkojmë nga ana juaj shqyrtimin dhe miratimin e përfaqësuesve të Bashkisë Durrës në bordet e institucioneve arsimore publike, sipas listës bashkëlidhur këtij relacioni.

Përgjegjëse Sektorit të Arsimit

Nikoleta Rusha

Drejtore e Drejtorisë Arsim, Kulturës, Rinisë,Sportit dhe Komuniteteve Fetare

Migena Muhaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS
DREJTORIA LIGJORE
SEKTORI JURIDIK

PROJEKT-VENDIM

NR_____ DATË___/___/ 2016

PËR

MIRATIMIN E KRIJIMIT TË "DURRËS PARKIM", SUBJEKT JURIDIK PUBLIK, SI INSTITUCION NË VARËSI TË BASHKISË DURRËS PËR ADMININISTRIMIN E SHËRBIMIT TË PARKIMIT PUBLIK ME PAGESË

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimin nr. 7, datë 10.06.2008, "Mbi rregullat, kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për përzgjedhjen e subjektit që do të kryejë administrimin e shërbimit të parkimit/ve me pagesë në rrugë", Vendimin e Këshillit Bashkiak Durrës nr. 66, datë 25.06.2024, "Për përcaktimin e zonave të administrimit të parkimit dhe tarifave të shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë dhe sheshe në territorin e Bashkisë Durrës" i ndryshuar, Marrëveshjes së nënshkruar midis Bashkisë dhe One Albania ShA, protokolluar me tonën nr. 10038 prot., datë 21.08.2025, Marrëveshjen e nënshkruar me Vodafone Albania ShA, për ofrimin e infrastrukturës të telefonisë celulare dhe vjeljen e tarifës së parkimit, protokolluar me tonën nr. 8444 prot., datë 09.07.2025 si dhe Marrëveshjen standarde për përpunimin e të dhënave", protokolluar me tonën nr. 8444/1 prot., datë 03.09.2025, Kontratë për pranimin e pagesave me karta, nënshkruar midis Bashkisë Durrës dhe Union Bank, protokolluar me tonën nr. 584/12 prot., datë 30.07.2026 dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria Ligjore, kryetarja e Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe,

TË VENDOSË:

1. Miratimin e krijimit të "Durrës Parkim", subjekt juridik publik, si institucion në varësi të Bashkisë Durrës me një numër të përgjithshëm prej 20 (njëzet) punonjësish.
2. Miratimin e detyrave kryesore institucionale e funksionale të këtij institucioni që do të jenë si më poshtë vijon:
   a. të administrojë shërbimin e parkimit publik me pagesë të Bashkisë Durrës mbi tokë dhe nëntokë, në përputhje me zonat e përcaktuara për këtë qëllim;
   b. të planifikojë dhe të ndjekë zbatimin e investimeve në infrastrukturën e nevojshme për shërbimin e parkimit publik me pagesë në Bashkinë Durrës;

c. të instalojë dhe mirëmbajë pajisjet dhe makineritë e parkimeve me pagesë;
ç. të instalojë dhe mirëmbajë sinjalistikën rrugore të parkimit;
d. të konstatojë dhe të vendosë gjoba në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë Bashkiake për kundërvajtjet administrative lidhur me qëndrimin përtej orarit të caktuar dhe mospagesën e tarifës së parkimit në përputhje me Vendimin e Këshillit Bashkiak Durrës nr. 66, datë 25.06.2024, "Për përcaktimin e zonave të administrimit të parkimit dhe tarifave të shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë dhe sheshe në territorin e Bashkisë Durrës" i ndryshuar;
e. të kryejë çfarëdo lloj aktiviteti tjetër që nuk bie në kundërshtim e që lidhet direkt apo indirekt me përmbushjen e detyrave institucionale e funksionale, si dhe të kryejë detyrat që i ngakohen njësisë së qeverisjes vendore në kuadër të administrimit të parkimit tokësor dhe nëntokësor me pagesë;
f. t'i propozojë Bashkisë Durrës përmirësimin e politikave të administrimit të parkimit tokësor dhe nëntokësor me pagesë.

3. Drejtoria e Burimeve Njerëzore të hartojë dhe të propozojë për miratim strukturën organizative, dhe rregulloren e funksionimit të brendshëm të "Durrës Parkim".
4. Miratimin e nivelit të pagave për punonjësit e "Durrës Parkim", sipas lidhjes nr.1 bashkëlidhur këtij vendimi.
5. Efektet financiare të këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i Bashkisë Durrës për vitin 2027.
6. Ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Kabinetit, Drejtoria e Buxhetit, dhe Drejtoria e Policisë Bashkiake për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar.

DREJTORIA LIGJORE
Drejtore

Alneida Rroshi

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE
Drejtore

Brunilda Gripshi

DREJTORIA E BUXHETIT
Drejtore

Valbona Qiriako

KRYETARE

Emiriana Sako

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

PËR

MIRATIMIN E KRIJIMIT TË "DURRËS PARKIM", SI SUBJEKT JURIDIK PUBLIK, INSTITUCION NË VARËSI TË BASHKISË DURRËS, PËR ADMININISTRIMIN E SHËRBIMIT TË PARKIMIT PUBLIK ME PAGESË

Të nderuar,

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimin nr. 7, datë 10.06.2008, "Mbi rregullat, kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për përzgjedhjen e subjektit që do të kryejë administrimin e shërbimit të parkimit/ve me pagesë në rrugë", Vendimin e Këshillit Bashkiak Durrës nr. 66, datë 25.06.2024, "Për përcaktimin e zonave të administrimit të parkimit dhe tarifave të shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë dhe sheshe në territorin e Bashkisë Durrës" i ndryshuar, Marrëveshjes së nënshkruar midis Bashkisë dhe One Albania ShA, protokolluar me tonën nr. 10038 prot., datë 21.08.2025, Marrëveshjen e nënshkruar me Vodafone Albania ShA, për ofrimin e infrastrukturës të telefonisë celulare dhe vjeljen e tarifës së parkimit, protokolluar me tonën nr. 8444 prot., datë 09.07.2025 si dhe Marrëveshjen standarde për përpunimin e të dhënave", protokolluar me tonën nr. 8444/1 prot., datë 03.09.2025, Kontratë për pranimin e pagesave me karta, nënshkruar midis Bashkisë Durrës dhe Union Bank, protokolluar me tonën nr. 584/12 prot., datë 30.07.2026 dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria Ligjore, relatojmë këtë relacion, si më poshtë vijon:

Një nga prioritetet kryesore të Bashkisë Durrës është përmirësimi i menaxhimit dhe organizimit të parkimit publik, i cili përbën një element thelbësor të sistemit të transportit urban dhe ndikon drejtpërdrejt në qarkullimin rrugor, aksesueshmërinë, zhvillimin ekonomik, cilësinë e mjedisit dhe përdorimin racional të hapësirës publike. Durrësi, si një nga qendrat më të rëndësishme urbane, ekonomike dhe turistike të vendit, përballet me një kërkesë gjithnjë e në rritje për hapësira parkimi, si rezultat i zhvillimeve demografike dhe socio-ekonomike, shtimit të numrit të automjeteve, flukseve turistike dhe intensifikimit të aktivitetit ekonomik.

Këta faktorë, të ndërthurur me karakteristikat e infrastrukturës rrugore dhe konfigurimin urban të qytetit, krijojnë problematika të veçanta në menaxhimin e trafikut, veçanërisht gjatë periudhave me fluks të lartë lëvizjeje. Në këto kushte, administrimi i parkimit publik kërkon një qasje të organizuar dhe të kontrolluar, e cila të mundësojë shfrytëzimin sa më efikas të kapaciteteve ekzistuese, rregullimin e kohëqëndrimit të automjeteve dhe garantimin e aksesit për kategori të ndryshme përdoruesish.

Për realizimin e këtyre objektivave, është parashikuar zbatimi i sistemit të parkimit të kontrolluar, nëpërmjet përcaktimit të zonave, tarifave, orareve dhe kushteve të përdorimit, duke krijuar një mekanizëm administrimi që i përgjigjet kërkesave të banorëve, vizitorëve, turistëve dhe subjekteve ekonomike, sikurse parashikohen në Vendimin e Këshillit Bashkiak Durrës nr. 66, datë 25.06.2024, "Për përcaktimin e zonave të administrimit të parkimit dhe tarifave të shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë dhe sheshe në territorin e Bashkisë Durrës" i ndryshuar.

Në këtë kontekst, administrimi i parkimit publik me pagesë dhe i hapësirave të dedikuara për rezidentët përbën një shërbim me rëndësi të veçantë, i cili kërkon një organizim institucional të qartë, përgjegjësi funksionale të përcaktuara dhe mekanizma të qëndrueshëm kontrolli e monitorimi. Për këtë arsye, nëpërmjet këtij relacioni, kërkojmë miratimin tuaj për krijimin e "Durrës Parkim" si person juridik publik në varësi të Bashkisë Durrës, me të drejta, detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara në rregulloren e brendshme dhe aktet e tjera përkatëse. Misioni kryesor i këtij institucioni është administrimi, organizimi dhe menaxhimi i shërbimit të parkimit publik me pagesë në territorin e Bashkisë Durrës, në rrugë dhe sheshe, si dhe administrimi i hapësirave të dedikuara për parkimin e rezidentëve, në përputhje me vendimmarrjen përkatëse të Këshillit Bashkiak me Vendimin nr.66/2024 të ndryshuar.

Nëpërmjet krijimit të këtij institucioni në varësi të Bashkisë Durrës, synohet përmirësimi i cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve, garantimi i transparencës në administrimin e të ardhurave që krijohen nga administrimi i parkimit me pagesë, si dhe forcimi i kontrollit mbi veprimtarinë administrative të institucionit.

Funksionimi i institucionit nëpërmjet Drejtorit dhe strukturave përgjegjëse për administrimin e shërbimit të parkimit, do të realizohet nëpërmjet kësaj organigrame e përbërë nga 20 punonjës:

-Drejtori i institucionit, Sektori i Inspektimit të Parkimit në Rrugë dhe Sheshe; Sektori i Rezidentit; Sektori i Burimeve Njerëzore; Sektori i Financës; Punonjës i ruajtjes së objekteve; Punonjës pastrimi dhe së mirëmbajtjes higjieno-sanitare.

Përcaktimi i këtyre strukturave synon ndarjen e qartë të funksioneve dhe përgjegjësive, shmangien e mbivendosjes së kompetencave dhe krijimin e një organizimi funksional, në përputhje me nevojat e institucionit. Gjithashtu, parashikohet që çdo punonjës të ketë kontratën individuale të punës dhe përshkrimin përkatës të punës, ku përcaktohen detyrat, përgjegjësitë, varësia hierarkike dhe kërkesat që lidhen me pozicionin e tij.

Miratimi për krijimin e institucionit "Durrës Parkim" pritet të sjellë përmirësime të ndjeshme në adminstrimit e shërbimit publik me pagesë duke synuar rritjen e eficiencës në administrimin dhe menaxhimin e parkimit publik me pagesë, përmirësimin e administrimit të shesheve të parkimit dhe hapësirave të dedikuara për rezidentët dhe rritjen e përgjegjshmërisë së punonjësve dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e administrimit të parkimit publik për organizimin e lëvizshmërisë urbane, nevojën për përcaktimin e qartë të përgjegjësive institucionale dhe domosdoshmërinë e krijimit të procedurave të standardizuara për funksionimin e institucionit "Durrës Parkim", vlerësojmë se miratimi i krijimit të këtij institucioni në varësi, përbën një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të administrimit të shërbimit të parkimit publik me pagesë.

Për sa më sipër, i propozojmë Këshillit Bashkiak Durrës shqyrtimin dhe miratimin e projektvendimit "Për miratimin e krijimit të "Durrës Parkim", si subjekt juridik publik, institucion në varësi të Bashkisë Durrës, për admininistrimin e shërbimit të parkimit publik me pagesë".

Faleminderit.

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Drejtore

Brunilda Gripshi

DREJTORIA LIGJORE

Drejtore

Alneida Rroshi

Lidhja nr.1

Nivelet e pagave për punonjësit e " "

Nr.	Emërtesat e pozicioneve të punës	PAGA BRUTO MUJORE (LEKE)			
I.	**Punonjës te sistemit me pagë për pozicion + shtesa e nivelit të kualifikimit(diploma)**	**Shtesa e nivelit të kualifikimit (Grupi i diplomës)**	**Paga per pozicion (lek në muaj)**	**Shtesa për vjetërsi (sipas mënyrës së llogaritjes të përcaktuar në shkronjën "a")**	**Shtesa për natyrë të veçantë pune**
I.1	Drejtor	1	100,000		-
I.2	Pergjegjes sektori	1	80,000		-
I.3	Specialist	1 ose 2 ose 3	70,000		-
II.	**Punonjës të tjerë të profesioneve të ndryshme**		**Paga bazë (lek në muaj)**	**Shtesa për vjetërsi**	**Shtesa për natyrë të veçantë pune**
II.3	Punonjës pastrimi, roje		50,000	1%	4,000

a) Shtesa për vjetërsi në punë **për pozicionet I.1, I.2, I.3 të jepet në masën:**
   i. 0.6 % pas çdo viti pune, pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e para (1–10 vjet) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
   ii. 0.8 (zero pikë tetë) % pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e dyta (11–20 vjet) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
   iii. 1 (një) % pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e treta (21–30 vjet) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

b) Shtesa për vjetërsi në punë **për pozicionin II.3** të jepet në masën 1% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën bazë.

Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit, sipas grupit të diplomës.

Grupi i diplomës	Niveli i kualifikimit sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve	Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit (lekë/muaj)
1	Niveli 7 i KSHK-së (Master i Shkencave. Master i Arteve; Master Profesional të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike; Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	14,000
2	Niveli 7 i KSHK-së (Master Profesional. Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	12,000
3	Niveli 6 i KSHK-së (Bachelor.)	10,000

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS
DREJTORIA LIGJORE
SEKTORI JURIDIK

PROJEKTVENDIM

Nr.____ , Datë ____/____/202_

PËR MIRATIMIN E Z. GEG ÇELA, SI PËRFITUES I MASËS SË GRANTIT TË RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE KATUND I RI, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, SIPAS PROJEKTIT MODEL

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Akti Normativ nr.9 datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore" miratuar me Ligjin nr. 97/2019, VKM nr. 5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të proçedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" i ndryshuar, VKM nr.904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe proçedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të proçesit të rindërtimit", i ndryshuar, Vendimi i Këshillit Bashkiak Nr.8 datë 28.01.2021 "Për miratimin e kontratës model për kalimin e masës së grantit të rindërtimit për banesat individuale të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019 sipas projekteve model nga Bashkia Durrës tek përfituesi" dhe sipas relacionit të hartuar nga Komsioni i posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit, në Bashkinë Durrës, kryetari i bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Durrës të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe,

TË VENDOSË:

1. Miratimin e z. Geg Çela, si përfitues i masës së grantit të rindërtimit të banesave individuale në njësinë administrative Katund i Ri, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, sipas projektit model.

2. Miratimin e vlerës financiare që do të përfitojë z.Geg Çela nga programi i proçesit të rindërtimit për rindërtimin e shtëpisë individuale në njësinë administrative Katund i Ri sipas tabelës së më poshtme:

Nr.	PRONARI	KONKLUZIONI I AKT EKSPERTIZËS	PËRBËRJA FAMILJARE	VLERA FINANCIARE E RINDËRTIMIT NË LEKË
1	GEG ÇELA	PRISHJE	7	3.428.958

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë Ligjore, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Urbanistikës, Planifikimit Urban dhe Zhvillimit të Territorit.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55 të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar.

DREJTORIA LIGJORE
Drejtor

Alneida Rroshi

KOMISIONI I POSAÇËM
Kryetar

Gentian Kallmi

KRYETAR

Emiriana Sako

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURËS
KOMISIONI I POSAÇËM

RELACION
PËR MIRATIMIN E Z. GEG ÇELA, SI PËRFITUES I MASËS SË GRANTIT TË RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE KATUND I RI, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, SIPAS PROJEKTIT MODEL

Të nderuar këshilltarë

Sikurse jeni në dijeni, tërmeti i fuqishëm i rënë në datën 26.11.2019, që tronditi Shqipërinë, përfshiu edhe territorin administrativ të Bashkisë Durrës, ku janë evidentuar dëme të shumta ndërtimore në të gjitha Njësitë Administrative në juridiksionin administrativ të saj. Nisur nga kjo ngjarje natyrore, e cila krijoi një situatë të papritur me pasoja të rënda për banorët e Bashkisë Durrës, duke cënuar sigurinë e tyre dhe shkaktuar dëme të mëdha për jetën e njerëzve, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 750, datë 27.11.2019, "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë", të ndryshuar, në të cilin ishte sanksionuar fakti se për përballimin dhe lehtësimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, institucionet publike ishin të detyruara të merrnin masa të jashtëzakonshme për përballimin e kësaj situate. Konkretisht, referuar pikës 7.1, shkronjat "a" dhe "'d" institucionet publike duhej të realizonin plane masash organizative dhe administrative për përballimin e gjendjes së fatkeqësisë natyrore dhe ndihmojnë në përballimin dhe lehtësimin e saj.

Në vijim, Këshilli i Ministrave, me qëllim intensifikimin e masave dhe veprimeve për përballimin e pasojave të kësaj fatkeqësie natyrore, si edhe të fatkeqësive të tjera që për shkak të intensitetit, të shkallës dhe të shtrirjes së tyre, kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme të të gjitha institucioneve të mbrojtjes civile, miratoi Aktin Normativ nr. 9, datë datë 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, i cili, ka si objekt kryesor të rregullojë funksionimin e organeve përgjegjëse për rehabilitimin dhe rindërtimin e komuniteteve dhe të territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, si dhe zhvillimin e territoreve të reja, duke përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, programet e procesit të rindërtimit, funksionimin e fondit të rindërtimit dhe procedurat përkatëse,

Në zbatim të këtyre parashikimeve dhe në funksion të fillimit të zbatimit të programeve të procesit të rindërtimit, Këshilli i Ministrave miratoi një sërë aktesh në zbatim të Aktit Normativ, në të cilat

u detajuan procedurat që duhet të ndiqen për secilin prej programeve, nga të cilat, më të rëndësishmet mund të përmendim vendimin nr. 904, datë 24.12.2019, "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit", të ndryshuar.

Vendimet e sipërcituara, krahas përcaktimit të procedurave dhe rregullave për të përfituar nga disa prej programeve të lartpërmendura, parashikojnë detyrimin e kryetarit të bashkisë për ngritjen e Zyre të Posacme të Rindërtimit për shqyrtimin e dosjeve dhe kualifikimin e tyre si dhe ngritjen e një Komisioni të Posaçëm që do të vlerësojë dhe shqyrtojë aplikimet për të përfituar nga programet e procesit të rindërtimit. Më specifikisht, detyrat konkrete të komisionit janë të përcaktuara në pikat e poshtëshënuara:

-Pika 8, e VKM-së nr. 904/2019: Kërkesat e plotësuara me të dhënat dhe dokumentacionin sipas parashikimit të këtij vendimi regjistrohen sipas rendit kronologjik në sistemin e posaçëm elektronik nga strukturat përgjegjëse. Regjistri i kërkesave për mbanin formacionin që mundëson përpunimin e të dhënave, si mëposhtë vijon: a) emrin, atësinë, mbiemrin; b) numrin e kërkesës; c) datën e dorëzimit/paraqitjes së aplikimit; ç) objektin e kërkesës, përfshirë edhe preferencën e paraqitur për programin e rindërtimit; d) adresën e kërkuesit; dh) përbërjen familjare në momentin e aplikimit; e) Aktin e konstatimit/akt ekspertizën e thelluar, të lëshuar nga çdo person fizikosejuridik, subjektisëdrejtëstregtare, ipajisur me lejen, licencën ose autorizimin përkatës nga autoritetet shtetërore për vërtetimin e gjendjes së rrezikut për jetën dhe shëndetin, në të cilin vërtetohen dëmet që ka pësuar ndërtesa apo që është shpallur si e pabanueshme; ë) dokumentin e pronësisë ose çdo akt përfitimin e pronësisë së banesës së dëmtuar.

- Pika 16, e VKM-së nr. 904/2019: "Për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit, në bazë të kritereve të përcaktuara në këtë vendim dhe listës së objekteve të vëna në dispozicion nga organi përgjegjës shtetëror, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, krijon një komision të posaçëm, i cili vlerëson kërkesat e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit, në bazë të dokumentacionit përkatës dhe parashikimeve të këtij vendimi, si dhe harton listën e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit.
- Pika 21, e VKM-së nr. 5/2020: "Për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programi i granteve të rindërtimit, në bazë të kritereve të përcaktuara në këtë vendim, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore ose autoriteti përgjegjës krijon një komision të posaçëm, i cili vlerëson kërkesat në bazë të dokumentacionit të kërkuar, sipas këtij vendimi."

Komisioni i Posaçëm i ngritur me Urdhërin nr.234 datë 18.08.2025, nr.9952 prot datë 18.08.2025 "Për riformatimin e komisionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga

programet e proçesit të rindërtimit ngritur me Urdhërin nr.164 datë 26.05.2020 "Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e proçesit të rindërtimit" i ndryshuar, në bazë të parashikimeve të legjislacionit në fuqi dhe të dokumentacionit përkatës nga Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike si dhe raporteve përkatëse bazuar në legjislacionin e sipërpërmendur dhe proçedurës së ndjekur nga Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike, Komisioni i Posaçëm, pasi vlerësoji dokumentacionin përkatës dhe raportet e dërguara nga kjo zyrë, i kërkon Këshillit Bashkiak:

1. Miratimin e z. Geg Çela, si përfitues i masës së grantit të rindërtimit të banesave individuale në njësinë administrative Katund i Ri, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 6 nëntor 2019, sipas projektit model.
2. Miratimin e vlerës financiare që do të përfitojë z.Geg Çela nga programi i proçesit të rindërtimit për rindërtimin e shtëpisë individuale në njësinë administrative Katund i Ri sipas tabelës së më poshtme:

Nr.	**PRONARI**	**KONKLUZIONI I AKT EKSPERTIZËS**	**PËRBËRJA FAMILJARE**	**VLERA FINANCIARE E RINDËRTIMIT NË LEKË**
1	GEG ÇELA	PRISHJE	7	3.428.958

KOMISIONI I POSAÇËM:

Gentian	Kallmi	Kryetar	Ana Hoxha	Anëtare
Andri	Cerri	Anëtar	Diana Mandia	Anëtare
Lulieta	Salillari	Anëtare	Alda Zyferi	Anëtare
Julian	Marku	Anëtar	Alneida Rroshi	Anëtare

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
DREJTORIA LIGJORE
SEKTORI JURIDIK

PROJEKTVENDIM

NR._____, DATË ____/____/2026

PËR VIJIMIN E PROÇEDURËS PËR PRISHJEN E DETYRUAR TË SEKSIONIT 2 (SHTESËS) TË PALLATIT NR.16, RRUGA "JAHJA BALLHYSA", LAGJA NR.17, KODI GIS 3102, DURRËS, PRONË PRIVATE NË ZBATIM TË OPONENCËS TEKNIKE TË HARTUARA NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT

Në zbatim të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", Akti Normativ nr.9 datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore" miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Ligji Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019 " Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Lezhë dhe Tiranë"; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 887, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësive natyrore", Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Projekteve, Infrastrukturës Publike dhe Transportit Publik, kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe,

TË VENDOSË:

1. Vijimin e proçedurës për prishjen e detyruar të seksionit 2 (shtesës) të pallatit nr.16 rruga "Jahja Ballhysa", Njësia Administative nr. 5, lagja nr.17, kodi GIS 3102, Durrës, pronë private në zbatim të oponencës teknike të hartuara nga instituti i ndërtimit.

2. Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Urbanistikës, Planifikimit Urban dhe Zhvillimit të Territorit, Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të ndjekin procedurat për aplikimin, shqyrtimin dhe miratimin e dokumentit për leje ndërtimi (prishjen e objektit të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore), sipas parashikimeve të akteve ligjore në fuqi.

3. Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit merr të gjitha masat për ndërhyrjen dhe prishjen e objekteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Me qëllim njoftimin e banorëve dhe palëve të interesuara, vendimi publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës, si dhe afishohet në këndin e njoftimeve pranë Njesisë Administrative nr. 5.

5. Ngarkohen kryetari i Bashkisë, Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë Ligjore, Drejtoria e Urbanistikës, Planifikimit Urban dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Projekteve, Infrastrukturës Publike dhe Transportit Publik, Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Durrës, Drejtoria e Kabinetit dhe Njësia Administrative nr. 5 për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar.

DREJTORIA E E PROJEKTEVE, INFRASTRUKTURËS PUBLIKE DHE TRANSPORTIT PUBLIK

Drejtore
Alda Zyferi

DREJTORIA LIGJORE

Drejtore
Alneida Rroshi

KRYETARE E BASHKISË

Emiriana Sako

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

RELACION

PËR VIJIMIN E PROÇEDURËS PËR PRISHJEN E DETYRUAR TË SEKSIONIT 2 (SHTESËS) TË PALLATIT NR.16, RRUGA "JAHJA BALLHYSA", LAGJA NR.17, KODI GIS 3102, DURRËS, PRONË PRIVATE NË ZBATIM TË OPONENCËS TEKNIKE TË HARTUARA NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT

Baza ligjore: Ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Akti Normativ nr.9 datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", Ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019 "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë", kontratës së shërbimit me objekt "Studim projektim i projekteve prioritare të infrastrukturës publike në Bashkinë e Durrësit", lidhur midis Bashkisë Durrës dhe bashkimit të operatorëve "NET-GROUP SHPK + VIANTE KONSTRUKSION SHPK", nr.10141/5 prot datë 31.12.2024, Proçesverbalit datë 25.03.2025 "Mbi marrjen në dorëzim të projekteve të kontratës së shërbim konsulence me objekt "Studim projektim i projekteve prioritare të infrastrukturës publike në Bashkinë e Durrësit", Oponenca e hartuar nga Instituti i Ndërtimit nr.827/2 prot, protokolluar me tonën nr.2797 prot datë 25.02.2026 "Dërgim oponence teknike të objekteve"

Të nderuar këshilltarë,

Bashkia Durrës pas proçedurës së prokurimit publik ka nënshkruar Kontratë Shërbimi me objekt "Studim projektim i projekteve prioritare të infrastrukturës publike në Bashkinë e Durrësit", lidhur midis Bashkisë Durrës dhe bashkimit të operatorëve "NET-GROUP SHPK + VIANTE KONSTRUKSION SHPK", nr.10141/5 prot datë 31.12.2024.

Në zbatim të kësaj kontrate, kontraktuesit hartojnë analizën e thelluar sipas VKM-së nr.26 datë 15.01.2020 "Për kryerjen e aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara", të cilën e paraqesin për oponencë teknike pranë Institutit të Ndërtimit.

Nga Instituti i Ndërtimit është hartuar oponenca teknike e projekteve të rikonstruksionit për të 7 objektet, sipas shkresës nr.827/2 prot datë 23.02.2026 protokolluar me tonën nr.2797 prot datë 25.02.2026, nga i cili rezulton se seksioni 2 i objektit pallati nr.16, rruga "Jahja Ballhysa", lagja nr.17, kodi GIS 3102, Durrës duhet të prishet.

Përsa më sipër në bazë të nenit 35, të Aktit Normativ nr. 9 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", prishja e detyruar e ndërtesave në pronësi private kryhet në çdo rast kur ndërtesa është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore dhe nuk mund të riparohet ose kur përbën rrezik për jetën dhe shëndetin e njerëzve, sipas ekspertizës së thelluar të Institutit të Ndërtimit.
Prishja e ndërtesave pronë private bëhet me vendim të njësisë së vetëqeverisjes vendore në territorin e të cës ndodhet ndërtesa.

Duke qënë se procesi i rindërtimit është një proces shumë i rëndësishëm, institucioni ynë ka për qëllim të jetë transparent dhe t'ju informojë për çdo hap dhe procedurë që do të ndjekë për ecurinë e këtij procesi siç ka bërë dhe më parë.

Procedurat do të zbatohen me korrektësi nga ana jonë, dhe vazhdimisht do të raportojmë pranë Këshillit Bashkiak për ecurinë e këtij procesi.

Për sa më sipër përmes këtij relacioni ju kërkojmë:

1. Vijimin e proçedurës për prishjen e detyruar të seksionit 2 (shtesës) të pallatit nr.16 rruga "Jahja Ballhysa", Njësia Administative nr. 5, lagja nr.17, kodi GIS 3102, Durrës, pronë private në zbatim të oponencës teknike të hartuara nga instituti i ndërtimit.

Duke Ju falenderuar, mbetemi të sigurtë në bashkëpunimin Tuaj.

DREJTORIA E PROJEKTEVE, INFRASTRUKTURËS PUBLIKE DHE TRANSPORTIT PUBLIK

Alda Zyferi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

DREJTORIA LIGJORE

SEKTORI JURIDIK

Nr _____ Prot. Durrës, më ___.___.2026

PROJEKT –VENDIM

NR_____, DATË___/___/ 2026

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË NR.RENDOR 2 TË ANEKSIT NR.1 MIRATUAR ME VENDIM TË KËSHILLIT BASHKIAK NR.42 DATË 09.07.2026 " PËR MIRATIMIN E LISTAVE SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË PALLATIN KASTRATI NR. 14, RRUGA "STEFAN DHIMA", NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; PALLATIN NR. 8, RRUGA "STEFAN DHIMA", NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 3; PALLATIN NR. 25/1, RRUGA "HYSEN MYSHKETA", NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 3; PALLATIN NR. 18, RRUGA "DAVID SELENICA", NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; PALLATIN NR. 52, RRUGA "SELVIA", NJËSIA ADMINISTRATIVE SUKTH; MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË NR. RENDOR 1 TË ANEKSIT NR. 1 "SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 2" TË VKB-SË NR. 79, DATË 29.07.2024, SI DHE MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË NR. RENDOR 1 TË ANEKSIT NR. 3 "SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 5" TË VKB-SË NR. 86, DATË 31.08.2020"

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar; Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me Ligjin nr. 97/2019; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019, "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë", të ndryshuar; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019, "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit", të ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 08.01.2020, "Për përcaktimin e procedurave për përfitimin nga programi i granteve të rindërtimit", të ndryshuar, si dhe në zbatim të Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë nr. 164, datë 26.05.2020, "Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit", të ndryshuar, dhe Urdhrit nr. 234, datë 18.08.2025, "Për riformatimin e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit", si dhe procedurës së ndjekur dhe raportit të dërguar nga

Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.42 datë 09.07.2026, si dhe relacionit të dërguar nga Komisioni i Posaçëm, Kryetaria e Bashkisë, i propozon Këshillit Bashkiak Durrës të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe,

TË VENDOSË:

1. Për miratimin e ndryshimit të nr.rendor 2 të Aneksit nr.1 të miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 42 datë 09.07.2026 "Për miratimin e listave së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në pallatin kastrati nr. 14, rruga "Stefan Dhima", njësia administrative nr. 5; pallatin nr. 8, rruga "Stefan Dhima", njësia administrative nr. 3; pallatin nr. 25/1, rruga "Hysen Myshketa", njësia administrative nr. 3; pallatin nr. 18, rruga "David Selenica", njësia administrative nr. 5; pallatin nr. 52, rruga "Selvia", njësia administrative sukth; miratimin e ndryshimit të nr. rendor 1 të aneksit nr. 1 "Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në njësinë administrative nr. 2" të vkb-së nr. 79, datë 29.07.2024, si dhe miratimin e ndryshimit të nr. rendor 1 të aneksit nr. 3 "Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në njësinë administrative nr. 5" të VKB-së nr. 86, datë 31.08.2020", si më poshtë vijon:

NR	PRONARI	PERBERJA FAMILJARE	STRUKTURA	VKB FITUES	PALLATI	SIP.NE M2 QE DO TE PERFITOHET
2	FATION SHKOZA, EDLIRA VRANOCI, MARINA VRANOCI, ERJONA VRANOCI	1	1+1	42 DT 09.07.2026	PALL KASTRATI, RAMADAN VELIU	80

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike, si dhe Komisioni i Posaçëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Këshilli Bashkiak dhe konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

KOMISIONI I POSAÇËM
Kryetar

Gentian Kallmi

DREJTORIA LIGJORE
Drejtore

Alneida Rroshi

KRYETARE

Emiriana Sako

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KOMISIONI I POSAÇËM

RELACION

PËR

"MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË NR. RENDOR 2 TË ANEKSIT NR.1 MIRATUAR ME VENDIM TË KËSHILLIT BASHKIAK NR.42 DATË 09.07.2026 " PËR MIRATIMIN E LISTAVE SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË PALLATIN KASTRATI NR. 14, RRUGA "STEFAN DHIMA", NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; PALLATIN NR. 8, RRUGA "STEFAN DHIMA", NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 3; PALLATIN NR. 25/1, RRUGA "HYSEN MYSHKETA", NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 3; PALLATIN NR. 18, RRUGA "DAVID SELENICA", NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; PALLATIN NR. 52, RRUGA "SELVIA", NJËSIA ADMINISTRATIVE SUKTH; MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË NR. RENDOR 1 TË ANEKSIT NR. 1 "SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 2" TË VKB-SË NR. 79, DATË 29.07.2024, SI DHE MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË NR. RENDOR 1 TË ANEKSIT NR. 3 "SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 5" TË VKB-SË NR. 86, DATË 31.08.2020"

Referuar Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar", Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019 "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë" të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit" të ndryshuar, Komisioni i Posaçëm në bazë të dokumentacionit përkatës dhe parashikimeve të legjislacionit në fuqi pas vlerësimit të dokumentacionit të të gjithë aplikantëve që rezultojnë përfitues sipas vendimeve të parashikuara përgjatë viteve për sa i përket pallatit "Kastrati", raportit të dërguar nga Zyra e Posaçme e Rindërtimit nr.9475 prot datë 07.07.2026, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.42 datë 09.07.2026, Raporit të hartuar nga Komisioni i Posaçëm miratuar nga Kryetari Bashkisë Durrës, më poshtë ju sqarojmë hollësisht procedurat e ndjekura në mënyrë që banorët përfitues të përfitojnë

sipërfaqet takuese që kanë pasur në pronësi në momentin e fatkeqësisë natyrore të tërmetit të datës 26 nëntor 2019.

Të nderuar këshilltarë,

Me Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 42 datë 09.07.2026 "Për miratimin e listave së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në pallatin kastrati nr. 14, rruga "Stefan Dhima", njësia administrative nr. 5; pallatin nr. 8, rruga "Stefan Dhima", njësia administrative nr. 3; pallatin nr. 25/1, rruga "Hysen Myshketa", njësia administrative nr. 3; pallatin nr. 18, rruga "David Selenica", njësia administrative nr. 5; pallatin nr. 52, rruga "Selvia", njësia administrative sukth; miratimin e ndryshimit të nr. rendor 1 të aneksit nr. 1 "Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në njësinë administrative nr. 2" të vkb-së nr. 79, datë 29.07.2024, si dhe miratimin e ndryshimit të nr. rendor 1 të aneksit nr. 3 "Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në njësinë administrative nr. 5" të VKB-së nr. 86, datë 31.08.2020", janë miratuar dhe përditësuar listat e përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për Pallatin "Kastrati". Sqarojmë se në procedurat e ndjekura nga Bashkia Durrës, këta subjekte kanë përfituar strukturën e apartamentit bazuar në gjendjen familjare sipas certifikatës familjare, bazuar në dispozitat ligjore të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore" si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019, "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit", të ndryshuar. Me shkresën nr. 8933 prot., datë 18.10.2021 Kastrati Group Sha ka shprehur gadishmërinë që të kontribuojë në rindërtimin e objektit "Godinë banimi dhe shërbimi" në rrugën "Dalip Peza", duke investuar dhe financuar specifikisht për sipërfaqet shtesë nga diferenca në m^2, të përfituara nga subjektet përfituese nga procesi i rindërtimit në zbatim të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore" të ndjekura nga Bashkia Durrës. Kjo kërkesë e këtij subjekti është përcjellë nga Bashkia Durrës me nr. 11326/1 prot., datë 21.10.2021 pranë Ministrisë së Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Komisionit të Shtetit për Rindërtimin si dhe Shoqërisë "Eagle Hills Enterprise Proprieties-Sole Proprietorship" në mënyrë që institucionet përgjegjëse të sipërcituara të vijonin procedurat ligjore që përkojnë me vendimmarrjen e KSHR-së si organ përgjegjës për bashkërendimin e veprimeve të institucioneve shtetërore dhe të subjekteve private. Komisioni Shtetëror i Rindërtimit me Vendimin nr.97, datë 17.11.2021 ka miratuar kërkesën për bashkëpunim si pjesë e financimit për rindërtimin e objektit godinë dhe shërbimi në rrugën "Dalip Peza" të sipërfaqeve shtesë nga diferenca në m^2 të përfituesve të shpallur me Vendimet e Këshillit Bashkiak nr.30, datë 26.03.2021, nr. 76, datë 28.06.2021, nr.120, datë 30.09.2021, nr. 143, datë 12.11.2021 dhe nr. 46, datë 31.05.2022.

Në vijim të procedurave të ndjekura, pranë Zyrës së Posacme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomik, janë përcjellë zyrtarisht shkresat protokolluar me tonën nr. 4687/1 prot.,

datë 22.04.2025 dhe nr. 4687/2 prot., datë 28.04.2025, ku është përcjellë Akt marëveshja me shoqërinë ndërtuese, shkresa e Drejtorisë së Përgjitshme të Thesarit për kontributin vullnetar të dhënë në kuadër të përballimit të pasojave të shkaktuara nga tërmeti i datës 26.11.2019, gjithashtu është përcjellë dhe lista e banorëve përfitues me sipërfaqet shtesë të apartamenteve të tyre, sipas Certifikatës të Regjistrimit të Pronës nga ASHK Durrës.

Në këtë marrëveshje të lidhur midis Shoqërisë "Pajtoni" shpk dhe Shoqërisë "Kastrati Energy Trade" datë 17.04.2025 sqarohet se rindërtimi i objektit financohet në zbatim të VKM-së nr. 1048, datë 9.12.2020 "Për miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Abu Dabit për zhvillim, në lidhje me projektin e strehimit" ku ADFD caktoi kompaninë "Eagle Hills Enterprise Proprieties-Sole Proprietorship" në rolin e menaxhuesit dhe supervizuesit të projektit. Me kontratën e nënshkruar nr.ALB-2021-3 midis Shoqërisë "Eagle Hills Enterprise Proprieties-Sole Proprietorship" dhe Shoqërisë "Pajtoni" shpk, kjo e fundit ngarkohet të kryejë punimet ndërtimore me sipërfaqe totale ndërtimore prej 17, 479 m^2. Përpos punimeve të cituara më sipër Shoqëria "Kastrati Energy Trade" merr përsipër të investojë si bashkëinvestitor për shtesë të sipërfaqes së ndërtimit me rreth 3500 m^2. Gjithashtu me shkresën nr.17 prot., datë 28.04.2025 protokolluar në Bashkinë Durrës me nr. 4687/2 prot., datë 28.04.2025, shoqëria "Kastrati" ka përcjellë konfirmimin e Ministrisë së Financave në lidhje me kontributin e dhënë në kuadër të përballimit të pasojave të shkaktuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019 si dhe listën e banorëve përfitues për këtë kontribut me sipërfaqet përkatëse.

Bazuar në nenin 21, të Aktit Normativ Nr.9, datë 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore" ku ndër te tjera parashikohet që :

- *Me financim nga fondi i rindërtimit apo me investime nga donatorët ndërtohen ose rikontruktohen ndërtesat e dëmtuara nga fatkeqësia natyrore, në truallin ekzistues, sipas parashikimeve të këtij akti.*
- *Përfitues të njësive të banimit në objektet e reja janë pronarët e njësive të banimit të objekteve të shembura, në trojet e të cilave ndërtohen objektet e reja. Struktura e njësisë së banimit që i kalohet përfituesve nuk duhet të jetë më e madhe se struktura e njësisë së banimit që përfituesi kishte në pronësi në objektin e shembur.*
- *Njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe autoritetet përgjegjëse shtetërore për planifikimin dhe zhvillimin e territorit marrin masa për të hartuar planet e detyruara vendore, me procedurë të përshpejtuar, që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.*

Nisur nga dispozitat e mësipërme janë miratuar nga Kryetari i Bashkisë Durrës PdyV me Vendimin nr.25, datë 11.04.2023, Vendimi nr. 1166-23/3, datë 04.09.2023 "Për miratimin e kërkesës për leje për ndërtime të reja në zonat e dëmtuara dhe në zonat e reja për zhvillim" si dhe leja e ndërtimit përkatëse.

Gjithashtu në këtë nen parashikohet detyrimi i Bashkisë Durrës që me përfundimin e ndërtimit të objekteve të reja, njësia zbatuese, përgatit listën e inventarit dhe dokumentacionin përkatës të njësive të banimit dhe shërbimit, nëse ka, dhe ia përcjell Këshillit të Ministrave dhe ky i fundit me

vendim i kalon objektet e reja në pronësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Njësia e vetëqeverisjes vendore ngarkohet të kryejë procedurat e kalimit të pronësisë si njësi individuale te përfituesit, nëpërmjet nënshkrimit të kontratës përkatëse e cila miratohet si format tip me vendim të këshillit të ministrave.

Duke qenë se qëllimi i legjislacionit në fuqi në fushën e rindërtimit ka për qëllim garantimin e kthimit në kushte optimale jetese si dhe duke marrë shkas që procesi i rindërtimit për këtë pallat është drejt përfundimit, nisur edhe nga arsyetimi i detajuar i përshkruar në relacion, kërkojmë nga ana juaj:

1. Miratimin e ndryshimit nr.rendor 2 të Aneksit nr.1 të miratuar me Vendimn e Këshillit Bashkiak nr. 42 datë 09.07.2026 "Për miratimin e listave së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në pallatin kastrati nr. 14, rruga "Stefan Dhima", njësia administrative nr. 5; pallatin nr. 8, rruga "Stefan Dhima", njësia administrative nr. 3; pallatin nr. 25/1, rruga "Hysen Myshketa", njësia administrative nr. 3; pallatin nr. 18, rruga "David Selenica", njësia administrative nr. 5; pallatin nr. 52, rruga "Selvia", njësia administrative sukth; miratimin e ndryshimit të nr. rendor 1 të aneksit nr. 1 "Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në njësinë administrative nr. 2" të vkb-së nr. 79, datë 29.07.2024, si dhe miratimin e ndryshimit të nr. rendor 1 të aneksit nr. 3 "Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në njësinë administrative nr. 5" të VKB-së nr. 86, datë 31.08.2020", si më poshtë vijon:

NR	PRONARI	PERBERJA FAMILJARE	STRUKTURA	VKB FITUES	PALLATI	SIP.NE M2 QE DO TE PERFITOHET
2	FATION SHKOZA, EDLIRA VRANOCI, MARINA VRANOCI, ERJONA VRANOCI	1	1+1	42 DT 09.07.2026	PALL KASTRATI, RAMADAN VELIU	80

KOMISIONI I POSAÇËM:

Gentian	Kallmi	Kryetar	Ana Hoxha	Anëtare	
Andri	Cerri	Anëtar	Diana Mandia	Anëtare	
Lulieta	Salillari	Anëtare	Alda Zyferi	Anëtare	
Redion	Tabaku	Anëtar	Alneida Rroshi	Anëtare	